

Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Ky kapitulli u kushtohet zgjidhjes së ekuacioneve. Do të rikujtojmë dy mënyrat e zgjidhjes së ekuacioneve me të cilat u njohëm në kapituj të mëparshëm: mënyra hamendje-kontroll-përmirësim, dhe mënyra në të kundërt (e arsyetimit në të kundërt). Pastaj do të mësojmë të përdorim një mënyrë më të frytshme: kryerjen e të njëjtit veprim në të dy anët e ekuacionit, e cila është edhe mënyra që ju e njihni më mirë. Ja një shembull i një lloj problemi që do të shqyrtojmë:

Problem: Madeline dhe Neil koleksionojnë autografë lojtarësh bejsbolli. Madeline ka 9 autografë më shumë se Neil. Të dy bashkë kanë 31 autografë gjithsej. Sa autografë ka secili?

Shenjoni me a sasinë e autografëve të Neil. Pastaj shkruani një ekuacion që tregon se Madeline dhe Neil kanë gjithsej 31 autografë:
 $a + a + 9 = 31$ ose $2a + 9 = 31$.

Fjalor Gjatë kësaj kohe, do të njihemi me dy terma të rinj:

hamendje

model

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Shihni nëse mund të gjeni shembuj ekuacionesh në punë, ose në vende që vizitoni. Mund të zgjidhni ndonjë prej këtyre ekuacioneve?